



# Buletini

- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- \* Aktivitetet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive
  - \* Aktivitete tjera

Nëntor 2017

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)

### Lejimi i përmbarimit dhe vendosja sipas prapësimit

Me 1 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Lejimi i përmbarimit dhe vendosja sipas prapësimit” .



Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurën e shqyrtimit të propozimit përmbarimor dhe lejimit të përmbarimit si dhe vendimet që

nxirren në fazën e shqyrtimit të prapësimit.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me bazat juridike për caktimin e përmbarimit dhe kushtet për lejimin e përmbarimit. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan kompetenca për vendosje lidhur me prapësimin dhe shkaqet për paraqitjen e tij.

Gjatë këtij trajnimi janë përdorë metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, ku pjesëmarrësit kanë qenë aktiv, për të arritur në tërësi objektivat e këtij trajnimi. Në trajnim kanë dominuar rastet lidhur me shqyrtimin e propozimit përmbarimor, lejimit të përmbarimit si dhe vendimet që nxjerrën në fazën e shqyrtimit të prapësimit.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore – të Departamentit të Përgjithshëm – divizioni civil.



## Program i specializuar trajnimi për forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave - sesioni III

Më 3 dhe 4 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi sesionin e tretë të programit të specializuar për forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave.

Ky trajnim kishte për synim thellimin e njohurive në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar për luftimin dhe zbulimin e pastrimit të parave si dhe masave adekuate parandaluese për veprat e kësaj natyre.

Në sesionin e parë u elaborua përdorimi i inteligjencës dhe parandalimi i shpëlarjes së parasë, procesi i grumbullimit dhe planifikimit të informatave për shpëlarjen e parave nga NJIF, natyra e rastit, analiza e raportit, adresimi i kërkesave, menaxhimi i rrezikut, pastaj si kuptohet kriminaliteti dhe identifikimi i kryerësve të veprave penale, dhe si bëhet identifikim i krimit të supozuar.

Në sesionin e dytë u elaborua mënyra e përgatitjes së materialeve lidhur me masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit për zbulimin e shpëlarjes së parave, llojet, kushtet,

personat kompetent për të lëshuar këto masa, përmbytja dhe kohëzgjatja e urdhrave për lëshim të masave, ndihma e organeve tjera për zbatimin e këtyre masave, mënyra e dorëzimit të shkresave, si dhe raportet tek palët lidhur me këto masa në procedurë.

Po ashtu gjatë këtij sesioni trajnues është elaboruar edhe paraja virtuale më saktësisht Bitcoin, përkufizimi i bitcoinit dhe funksionet e tij.

Vëmendje të veçantë gjatë trajnimit kishte furnizimi me para Bitcoins e cila nuk varej nga politika monetare e ndonjë banke qendrore virtuale, por që zhvillohej bazuar në përdoruesit e interesuar për të vepruar me këtë aktivitet.

Trajnimi u zhvillua në formë interaktive me trajtimin e një rasti, ku u diskutua rreth sfidave në praktikë dhe vështirësive që gjyqtarët dhe prokurorët hasin gjatë punës së tyre.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të niveleve të ndryshme



## Procedura e vendosjes sipas mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme

Me 08 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temë “Procedura e vendosjes sipas mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e njohurive të pjesëmarrësve në zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me të drejtën dhe zhvillimin e shkathhtësive në ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Seanca e trajnimit u nda në dy pjesë dhe u prezantua nga trajnerët, duke përfshirë ankesën si mjet të rregullt juridik dhe shkaqet ankimore, kufijtë e ekzaminimit dhe vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, lidhur me vendosjen për ankesën.

Gjatë këtij trajnimi janë dhënë shpjegime lidhur me mjetet e jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve gjyqësore siç janë revizioni,

kërkesa për përsëritjen e procedurës kontestimore dhe propozimi për ushtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Të gjitha këto me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore në rastet kur vendoset me këto mjete juridike e veçmas me revizionin dhe kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë.

Dilemat dhe pyetjet gjatë trajnimit u adresuan përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, si dhe punës në grupe të pjesëmarrësve, duke u bazuar në raste dhe duke përdorur shembuj konkret nga praktika gjyqësore aktuale.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e gjykatave themelore, bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil.



## E drejta për t'iu drejtuar Gjykatës

Me 9-10 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Mjedisit – REC, dhe Shkollën e Magjistraturës në Tiranë, ka realizuar punëtorinë me temë: “E drejta për t’iu drejtuar Gjykatës”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte përfitimi i njohurive lidhur me mundësinë e gjyqtarëve dhe profesionistëve ligjor nga Kosova dhe Shqipëria, për t’iu drejtuar gjykatës në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian dhe legjislacionin kombëtarë.

Punëtorja ishte e fokusuar në dhënien e njohurive për kërkesat lidhur me qasjen në drejtësi për rastet mjedisore, Konventën e Aarhusit, struktura, të drejtat, baza ligjore, aplikimi i përgjithshëm në UNICEF, si dhe legjislacionin e BE-së.

Ditët e para të punëtorisë pjesëmarrësit kishin mundësinë të përfitojnë njohuri më të detajuara lidhur me zbatimin e shtyllës së tretë të Konventës së Aarhusit dhe rolin e gjyqtarëve si dhe perspektiva e OSHC (Organizatave të Shoqërive Civile) lidhur me qasjen në drejtësi.

Një pjesë e punëtorisë i është kushtuar diskutimeve që ka të bëjë me të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës lidhur me marrjen e informacionit në përputhje me Konventën e Aarhusit dhe legjislacionin kombëtarë. Pjesa tjetër e punëtorisë ka përmbajtur tema dhe diskutime lidhur me pjesëmarrjen e publikut në përputhje me Konventën e Aarhusit.

Punëtorja është bazuar në raste studimore konkrete dhe çështje gjyqësore demonstrative për të treguar aspektet më problematike lidhur me të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës për çështje mjedisore.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin: gjyqtarë, prokurorë, përfaqësues nga Ministria për Mbrojtje të Ambientit nga Kosova si dhe gjyqtarë, prokurorë përfaqësues nga Ministria për Mbrojtje të Ambientit, dhe përfaqësues nga Shoqëria Civile nga Shqipëria.

Nga Akademia e Drejtësisë në këtë punëtori kanë marrë pjesë: Valon Kurtaj, Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë dhe Kadrije Bicaj, Zyrtare e Larte për Trajnime në PTV.



## Masat për sigurimin e pranisë së të miturit në procedurë

Më 10 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Masat për sigurimin e pranisë së të miturit në procedurë”.



Ky trajnim kishte për qëllim avancimin e njohurive të pjesëmarrësve lidhur me zbatimin në praktikë të masave për sigurimin e të miturit në procedurë, problemet që paraqiten me rastin e moszbatimit apo zbatimit jo të drejtë të këtyre dispozitave ligjore dhe efektin e tyre në procedurën gjyqësore.

Në fokus të trajnimit ishin masat që Kodi i

Drejtësisë për të Mitur ka paraparë në përputhje me dispozitat e KPPK-së për të siguruar prezencën e të miturit në procedurë, për pengimin e ri kryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale si: thirrja, urdhër arresti, ndalimi policor, arresti i përkohshëm dhe paraburgimi.

Gjithashtu u diskutua për elementet e caktimit të paraburgimit dhe kushtet ligjore të caktimit të masave për sigurinë e pranisë së të miturit në procedurë, si dhe respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut në rastet e shqiptimit të këtyre masave.

Metodologjia e zhvilluar në këtë trajnim ishte e kombinuar me ligjërime teorik, raste dhe detyra praktike dhe diskutime për problemet dhe sfidat që hasen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor - Departamenti për të Mitur, nga regjione të ndryshme të Kosovës.



## Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale

Më 14 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në implementimin e drejtë të dispozitave dhe kushteve ligjore lidhur me rrethanat në të cilat mund të vendoset, duke përfshirë standardet ndërkombëtare për aplikim të paraburgimit si masa më e rëndë që mund të përcaktohet për sigurinë e të pandehurit në procedurë gjyqësore.

Në kuadër të këtij trajnimi u elaboruan çështjet rreth masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale. Vëmendje

parësore iu kushtua paraburgimit, si masë me të cilën sigurohet prezenca e të pandehurit si dhe të mbrohen qytetarët nga kryesi i veprës penale duke arritur efikasitet në procedurën penale. Paraprakisht, u trajtuan edhe masa e arrestit shtëpiak, paraqitja në stacionin policor, ndalimi për të i'u ofruar viktimës, dorëzania dhe masat tjera.

Metodologjia e aplikuar gjatë trajnimit ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe puna në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor si dhe bashkëpunëtorë profesional nga të gjitha rajonet e Kosovës.



## Të drejtat e pronësisë intelektuale - të drejtat e autorit

Me datën 15 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Të drejtat e pronësisë intelektuale - të drejtat e autorit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me të drejtat nga pronësia intelektuale, përfshirë të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta si dhe markat tregtare.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me kuptimin e të drejtave të autorit dhe autorizimet e titullarit të së drejtës, mbrojtjen juridike në aspektin civil dhe penal, dhe mbrojtjen alternative të të drejtave të autorit – shoqatave profesionale. Ndërsa, në pjesën e dytë u trajtua procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe kontrata për bartjen e të drejtës së autorit.

Gjatë këtij trajnimi janë përdorë metoda të kombinuara të shpjegimit dhe ligjërimit të pjesshëm, diskutimit interaktiv në mes pjesëmarrësve dhe ligjëruesve duke dhënë mendimet e tyre profesionale, sentenca të pasura nga praktika gjyqësore, e rajonit dhe ajo e GJDBE. Janë komentuar dispozitat e direktivave kryesore të BE-së dhe burimeve tjera ligjore si dhe janë trajtuar raste praktike, si dhe vendime të ndryshme duke i ilustruar me interpretime dhe shembuj nga praktika e pasur gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, në Luksemburg, në lëmin e mbrojtjes së të drejtave të autorit.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm – divizioni civil dhe zyrtarë ligjor nga CLE.





## Korrupsioni, teknikat e hetimit

Më datën 15 dhe 16 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit të BE-së "Fuqizimi i efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë", realizoi trajnimin me temë "Korrupsioni teknikat e hetimit".

Qëllimi i trajnimit ishte t'iu mundësoj pjesëmarrësve të thellojnë njohuritë rreth plotësimit të kushteve ligjore përmes një rasti real praktik lidhur me korrupsionin, teknikat e hetimit, fazat fillestare të hetimit dhe si ndërmerret hetimi në rastet e korrupsionit kur kemi dy kompani njëra publike e tjetra private që dyshohet se janë të përfshira në korrupsion.

Në kuadër të këtij trajnimi u elaboruan çështjet rreth cilësimit dhe vlerësimit të provave tek veprat penale të korrupsionit. Paraprakisht,

vëmendje parësore iu kushtua çështjeve rreth teknikave të zbulimit dhe hetimit, për shkak të grumbullimit të provave të cilat janë shumë të rëndësishme në rastet kur kemi të bëjmë me veprat penale të kësaj natyre, që në praktikë nevojitet edhe bashkëpunimi ndërkombëtarë me qëllim të shkëmbimit të informatave si dhe sigurimin e provave për një procedurë të efektshme penale.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive të shembujve nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë nga Prokuroria Speciale e Kosovës si dhe Njësi Antikorrupsion nga Policia e Kosovës.



## Tryezë e rrumbullakët

### “Trajtimi i dilemave aktuale në Ligjin për Konfliktet Administrative”

Me 17-18 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ, realizoi tryezën e rrumbullakët me temë “Trajtimi i dilemave aktuale në Ligjin për Konfliktet Administrative”.



Qëllimi i organizimit të tryezës ishte trajtimi i dilemave të Ligjit të Procedurës Administrative nga panelistët, për gjyqtarë të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit, dhe gjykatave themelore, si dhe organet e tjera përkatëse administrative.

Në ditën e parë u trajtuan dilemat që janë paraqitur në praktikë lidhur me inicimin e konfliktit administrativ, shqyrtimin e padisë, shqyrtimin kryesor dhe nxjerrjen e aktgjykimit. Gjithashtu u trajtuan edhe çështjet që janë paraqitur në praktikë lidhur me dispozitat e LKA-së mbi ankesën dhe nxjerrjen e vendimit nga departamentet për çështje administrative të Gjykatës së Apelit dhe atyre themelore.

Në ditën e dytë janë trajtuar dilemat që janë paraqitur në praktikë gjatë zbatimit të dispozitave të LKA-së mbi mjetet e jashtëzakonshme juridike dhe nevojën lidhur me harmonizimin e ligjeve materiale të veçanta

me LKA-në.

Zyrtarët e institucioneve pjesëmarrës, gjatë gjithë diskutimeve kanë shtruar pyetje dhe dilema që hasin gjatë në punën e tyre të përditshme e njëkohësisht kanë marrë sqarime dhe përgjigje me dobi nga panelistët dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit në këto pyetje.

Njëkohësisht, në këtë tryezë janë paraqitur qëndrimet e institucioneve pjesëmarrëse, kur janë palë në procedurën administrative dhe procedurën e konfliktit administrativ.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin gjyqtarë të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Administrative, ekspert të GIZ-it, zyrtarë të Administratës Tatimore të Kosovës, Doganave të Kosovës, Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës për Miniera dhe Minerale, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Departamentit të Pensioneve - MPMS.



## Personat juridik dhe procedura kundërvajtëse

Më 21 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Personat juridik dhe procedura kundërvajtëse”

Ky trajnim kishte për qëllim të kontribuoj në avancimin e njohurive të gjyqtarëve, lidhur me legjislacionin e zbatueshëm rreth statusit juridik të subjekteve afariste në procedurën gjyqësore.

Në fokus të këtij trajnimi ishin temat si: mënyra e zhvillimit të procedurës për kundërvajtje ndaj subjektit afarist me cilësi të personit juridik dhe ndaj personit përgjegjës në personin juridik, përgjegjësia e personit juridik

dhe e personit përgjegjës të personit juridik, subjektet afariste si biznese individuale dhe zhvillimi i procedurës ligjore ndaj tyre dhe përgjegjësia e personit fizik.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve, ku pjesëmarrësit patën mundësinë që përmes shembujve praktik të kontribuojnë në unifikimin e praktikës gjyqësore në këtë fushë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë nga gjykatat themelore, Departamenti i Përgjithshëm - divizioni për kundërvajtje.



## Fillimi i hetimit dhe procedura penale

Më 22 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka mbajtur trajnimin me temën “Fillimi i hetimit dhe procedura penale”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte të sqaroj në mënyrë të hollësishme rolin e prokurorit të shtetit në fazën e hetimeve si një fazë shumë e rëndësishme në procedurën penale si dhe zbatimin e drejtë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, kur kemi të bëjmë me hetimet dhe kohëzgjatjen e tyre.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan çështjet që kanë të bëjnë me fillimin e hetimit si veprim me rëndësi në procedurën penale. Prokurori i shtetit pas pranimit të kallëzimit penal, e fillon ndjekjen penale pas nxjerrjes së aktvendimit për fillim të hetimeve në kuptim të dispozitave përkatëse ligjore.

Vëmendje parësore iu kushtua fillimit të hetimit, shkaqet e pezullimit të hetimit, pushimit të hetimit si dhe kohëzgjatjes së hetimit, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në procedurën penale me qëllim të grumbullimit të provave.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe puna në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor nga të gjitha regionet e Kosovës.



## Tregjet e zeza të internetit dhe krimi i organizuar

Me 23-24 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimeve të Vazhdueshme, në bashkëpunim me EULEX-in, ka organizuar trajnimin me temë “Tregjet e zeza të internetit dhe krimi i organizuar”.

Qëllimi i realizimit të këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve ekzistuese brenda autoriteteve përkatëse të drejtësisë për të luftuar tregjet e zeza të internetit dhe krimin e organizuar, trajtimi i sfidave dhe praktikave më të mira eventuale të institucioneve përgjegjëse për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit, si dhe llojeve të ndryshme të rreziqeve virtuale dhe krimit kibernetik.

Fokus i këtij trajnimi ishte elaborimi i kornizës ligjore vendore dhe ndërkombëtare që rregullon këtë fushë, sfidat dhe dilemat rreth zbatimit të dispozitave nga ana e prokurorëve për të hetuar në mënyrë më efektive dhe për të ndjekur penalisht krimin e organizuar dhe terrorizmin, me theks të veçantë mbledhja e dëshmive materiale në rastet e krimit kibernetik.

Gjithashtu u trajtuan çështjet lidhur me tregjet e zeza të internetit kundrejt tregjeve tradicionale për mallrat e paligjshme, si mund

të zbulohen dhe hetohen tregjet e zeza të internetit me lidhjet në mediat sociale, struktura e tyre dhe qasja. Vëmendje e veçantë iu kushtua bashkëpunimit polici-prokurori dhe sfidat – hetimi i transaksioneve në tregjet e zeza të internetit, si dhe respektimi i së drejtës në privatësi.

Nga ana e ekspertit ndërkombëtarë, në këtë trajnim dyditorë është prezantuar edhe një mjet praktik i lehtë për t'u konsultuar për prokurorët vendas që përballen me sfidën e re të përfshirjes së provave kibernetike në hetimet konvencionale, i quajtur si *Udhëzime të Shkurtra për Policinë dhe Prokurorët për Hetimin e Tregjeve të Zeza të Internetit*.

Trajnimi u realizua duke përdorur metoda të kombinuara të shpjegimit, shpjegime teorike dhe praktike, si dhe punë në grupe ku pjesëmarrësit patën mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorë të nivelit të apelit dhe nivelit themelor, gjyqtarë të nivelit themelor dhe zyrtarë nga Policia e Kosovës.



## Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre

Më 24-25 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre”

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i njohurive teorike dhe praktike të pjesëmarrësve, lidhur me interpretimin dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me procedurën e kundërshtimit dhe procedurën e njohjes së atësisë dhe amësisë, në drejtim të mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës, në rastet e ndërrimit të statusit të tyre dhe rastet e dhunës në familje.

Gjatë këtij trajnimi, u trajtua statusi i fëmijës dhe vërtetimi i statusit martesor, fëmijët martesor dhe jashtëmartesor, mënyrat e vërtetimit të marrëdhënieve prindërore jashtëmartesore, pasojat për fëmijën në rastet e

kundërshtimit të atësisë dhe amësisë dhe efektet juridike të njohjes së atësisë dhe amësisë në procedurë gjyqësore.

Më tej, u shtjelluan të drejtat e fëmijëve në rastet e dhunës në familje, llojet e urdhër mbrojtjeve dhe masave mbrojtëse kundër dhunës në familje të cilat mund t'i caktoj gjykatata.

Metodologjia e zhvilluar në këtë trajnim ishte e kombinuar me ligjërime teorik, raste dhe detyra praktike dhe diskutime për problemet dhe sfidat që hasen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të gjykatave themelore nga departamenti i përgjithshëm - divizioni civil si dhe përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale.



## Veprat penale kundër ekonomisë

Më 29 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Veprat penale kundër ekonomisë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve në implementimin e drejtë të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës me të cilat janë sanksionuar veprat penale kundër ekonomisë.

Në kuadër të këtij trajnimi u elaboruan çështjet rreth veprave penale kundër ekonomisë, të cilat shkaktojnë dëm financiar të pariparueshëm për shtetin, çështjet që janë të lidhura ngushtë me evazionin tatimor, pastrimin e parave, mashtrimin dhe falimentimin.

Gjatë trajnimit është diskutuar nevoja e bashkëpunimit në mes institucioneve, me ç'rast do të rritej sukseesi në luftimin e kësaj dukurie e

cila është mjaftë e shfaqur.

Vëmendje parësore iu kushtua veprave penale të cilat jo vetëm që janë objekt hetimi nga prokuroria, por edhe gjykatat kanë shumë lëndë të këtyre veprave penale, të cilat kërkojnë që të gjykohen, sepse ndikojnë shumë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Metodologjia e aplikuar gjatë trajnimit ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive si dhe puna në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga regjionet e ndryshme të Kosovës.



## Sigurimi i kërkesëpadisë

Më 30 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Sigurimi i kërkesëpadisë”.

Synimi i trajnimit ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me llojet e masave të sigurimit të kërkesëpadisë, kompetenca për të vendosur për masat e sigurimit të kërkesëpadisë, masat e përkohshme dhe kohëzgjatja e tyre, si dhe garancioni me rastin e caktimit të masës së sigurimit të kërkesëpadisë.

Në sesionin e parë u elaborua sigurimi i kërkesëpadisë i cili iu ofron mbrojtjen juridike palëve në konteste, në situata kur ekziston rreziku se zbatimi i sanksionit juridik civil nuk e jep rezultatin e duhur.

Lidhur me këtë u theksua se mbrojtja e tillë juridike ofrohet me caktimin e masave të

sigurisë të parapara me dispozitat e LPK-së, me të cilat sigurohet kërkesa e paditësit deri në përfundimin e procedurës me vendim të formës së prerë.

Në sesionin e dytë u elaboruan kompetencat për të vendosur për masat e sigurimit të kërkesëpadisë kur kemi të bëjmë me aktgjykim të formës së prerë. Po ashtu u shtjelluan edhe masat e përkohshme, procedura e caktimit të tyre dhe aktvendimi mbi caktimin e masave të sigurimit.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive të shembujve nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët nga gjykatat themelore veçanërisht Departamenti i Përgjithshëm - divizioni civil.





## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

Akademia e Drejtësisë, me qëllim të përmbushjes së programit trajnues, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar prokurorët e sapoemëruar të shtetit.

Në kuadër të trajnimit teorik, janë zhvilluar aktivitetet si në vijim: nën-moduli “Shmangia nga ndjekja penale” është realizuar përmes një (1) sesioni trajnues në këtë periudhë, nën-moduli “Vija ndarëse në mes të veprave penale dhe kundërvajtjeve” po ashtu është realizuar përmes një (1) sesioni trajnues.

Gjithashtu, janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnime nga nën-moduli “Roli i prokurorit në procedurën penale” ku ndër të tjera janë trajtuar roli i prokurorit të shtetit gjatë shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë, roli i prokurorit të shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor,

marrja e drejtpërdrejt në pyetje, marrja e tërthortë në pyetje dhe rimarrja në pyetje e dëshmitarit (neni 332 KPPK), roli i prokurorit në fjalën përfundimtare, fjala përfundimtare e prokurorit të shtetit dhe përmbajtja e fjalës përfundimtare (neni 353).

Në këtë kuadër, janë realizuar edhe pesë (5) sesione trajnuese nga nën-moduli “Arsyetimi i vendimeve (ankesave/akteve akuzuese), ku janë elaboruar këto tema: parimet e shkrimit ligjor, shkrimi ligjor dhe metodologjia e përdorimit të formulës IRAC, arsyetimi ligjor, arsyetimi i akteve të prokurorit, interpretimi i drejtë i normave ligjore dhe arsyetimi.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktikë, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e prokurorëve të sapoemëruar në prokuroritë përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program.



## Trajnimi praktik me gjyqtarët e sapoemëruar në Policinë e Kosovës

Më 15 nëntor 2017, në kuadër të vizitave në institucionet jo-gjyqësore, si pjesë e programit të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ka realizuar trajnimin praktik në këtë institucion.

Trajnimi në këtë institucion, kishte për qëllim që gjyqtarët e sapoemëruar të avancojnë njohuritë e tyre rreth mandatit, rolit, strukturës dhe punës praktike të Policisë së Kosovës.

Fillimisht, gjyqtarët e sapoemëruar u njoftuan me bazën ligjore dhe strukturën organizative të Policisë së Kosovës, rolin e saj, llojet e hetimeve, bashkëpunimin ndërkombëtarë në

fushën e zbatimit të ligjit, ngritjen e kapaciteteve, si dhe sfidat me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e policisë, e që ndërlidhen me punën e gjykatave, me fokus të veçantë në defektet e hasura gjatë punës praktike gjatë zbatimit të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, e të cilat afektojnë në efektivitetin e Policisë së Kosovës.

Gjyqtarët e sapoemëruar kishin mundësinë të paraqesin çështjet që ju interesonin dhe të diskutonin për punën e Policisë së Kosovës dhe rolin e saj në raport me gjykatat.

Përfitues të këtij trajnimit ishin gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së VI të PTF-së.



## Vizitë me gjyqtarët e sapoemëruar në Doganën e Kosovës

Më 29 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, ka realizuar vizitën me gjyqtarët e sapoemëruar, në këtë institucion.

Qëllimi i vizitës ishte që gjyqtarët e sapoemëruar të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me fushë-veprimtarinë e Doganës së Kosovës në përgjithësi, punën praktike dhe fushat e interesit të përbashkët në veçanti.

Në kuadër të kësaj vizite, shkurtimisht u elaborua historiku dhe procesi i zhvillimit të Doganës, roli dhe misioni i saj, legjislacioni mbi të cilin ushtron kompetencat e saj, struktura organizative si dhe bashkëpunimi me institucionet tjera të zbatimit të ligjit.

Me tej, u diskutuan çështjet praktike në sistemin e të drejtës penale në fushën e doganave, krahasimin e neneve përkatëse të Kodit Penal dhe Kodit Doganor që rregullojnë këtë materie, ku u paraqiten sfidat aktuale që has Dogana e Kosovës në këtë fushë.

Në këtë kuadër, po ashtu u diskutua rreth mënyrave adekuate të bashkëpunimit dhe avancimit të këtij kodi, me qëllim luftimin e suksesshëm dhe ndëshkimin e dukurive negative të kësaj natyre

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapoemëruar, gjenerata e VI-të e Programit për Trajnim Fillestar.



## Aktivitetet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive

### Hartimi ligjor për zyrtarët ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional

Me 16-17 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX-i, ka organizuar trajnimin me temë “Hartimi ligjor për zyrtarët ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional”.



Ky trajnim kishte si synim ngritjen e kapacitetit të pjesëmarrësve në lidhje me teknikat e përgjithshme të hartimit ligjor, në mënyrë që t’iu sigurohet një kuptim më i zgjeruar se si t’i identifikojnë dhe të trajtojnë sfidat në hartimin ligjor, të pajisen me njohuri themelore të avokimit me shkrim si dhe me aftësi për të hartuar kërkesa, vendime dhe arsyetime të hollësishme dhe të fokusuara.

Në ditën e parë të këtij trajnimi nga ana e ekspertëve të Gjykatës Ndërkombëtare Penale u elaboruan parimet dhe rregullat e përgjithshme të hartimit ligjor, strukturimi i parashtrësave dhe ndërtimi i argumentit, dhe në fund është zhvilluar një ushtrim i punës në grupe lidhur me përpilimin e një kërkesë për

paraburgim.

Në ditën e dytë janë trajtuar çështjet lidhur me mënyrën e qasjes së hartimit të llojeve të ndryshme të kërkesave ose parashtrësave, hartimit të ankesave, përgjigjes ndaj parashtrësave të palës kundërshtare, si dhe etika në hartimin ligjor. Gjithashtu edhe kjo ditë e punës u finalizua me punën në grupe, lidhur me përpilimin e një rasti nga praktika gjyqësore, ku pjesëmarrësit patën rastin të demonstrojnë teknikat e tyre të hartimit ligjor, si dhe njëkohësisht të përfitojnë eksperiencën nga ekspertiza e ofruar sipas perspektivës së BE-së, se si duhet vepruar për të qenë i saktë dhe preciz në hartimin ligjor, brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Metodologjia e këtij trajnimi ishte e kombinuar përmes prezantimeve me shembuj, ushtrimeve grupore si dhe diskutimeve të shumta, ku pjesëmarrësit shkëmbyen përvojat e tyre dhe përfituan njohuri të reja të cilat do t’iu ndihmojnë për të qenë më produktiv në detyrat e tyre të përditshme të deleguara nga prokurorët.

Përfitues të këtij trajnimi ishin zyrtarët ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional të prokurorive nga të gjitha nivelet.



## Etika dhe sjellja profesionale

Më 30 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë me mbështetje të GIZ, ka realizuar trajnimin me temë “Etika dhe sjellja profesionale”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i njohurive të stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive për zbatimin e kodit etik dhe sjelljes profesionale, të cilat janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me punën të cilën ata e ushtrojnë në gjykata dhe prokurori.

Trajnimi u fokusua kryesisht në elaborimin e normave etike të zbatueshme për rritjen e

cilësisë profesionale të punës së stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive.

Vështrime analitike dhe përmbajtjesore iu kushtua parimeve të kodit të etikës për stafin administrativ, disiplina në punë, paañësia dhe efikasiteti në punë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive nga regjione të ndryshme të Kosovës



## Aktivitetet tjera

### Konferenca Rajonale “Liria e shprehjes dhe interneti”

Më 2-3 nëntor 2017, në Budvë të Malit të Zi, në kuadër të projektit “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore – JUFREX” me mbështetje nga BE dhe Këshilli i Evropës, është mbajtur konferenca e tretë rajonale me temë “Liria e shprehjes dhe interneti”.



Qëllimi i kësaj konference ishte rritja e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve pjesëmarrës që merren me çështjet e lirisë së shprehjes, si dhe përmirësimi i zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e lirisë së shprehjes, në punën e përditshme të gjyqësorit përmes interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit vendor në linjë me standardet evropiane.

Punimet gjatë kësaj konference dyditore janë zhvilluar fillimisht me elaborimin e temave kryesore nga ana e ekspertëve me përvojë nga Gjykata e Strasburgut si: konceptet e jetës private dhe lirisë së shprehjes, kufiri i çmueshmërisë dhe vlerësimit të shteteve për nivelin e ndërhyrjes së lejuar në lirinë e mbrojtur të shprehjes, interneti-privatësia dhe liria e shprehjes, liria e shprehjes dhe fyerja, si dhe gjuha e urrejtjes. Të gjitha këto tema ishin të përcjella edhe me shembuj konkret nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së.

Ndërsa në ditën e dytë të kësaj konference pjesëmarrësit janë ndarë në grupe punuese, duke trajtuar kështu raste të ndryshme, për të shkëmbyer praktikën e mira dhe për të siguruar mbështetje të ndërsjellë për zhvillimin e praktikës gjyqësore vendase në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për çështjet e mediave, gjegjësisht nenit 10.

Delegacioni pjesëmarrës nga Kosova ishte i përbërë nga tre gjyqtarë, dy prokurorë, dy avokatë dhe një përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës.



## Takimi me Drejtorin e Akademisë së Drejtësisë - Brandenburg

Me 03 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë ka realizuar takimin me Drejtorin e Akademisë së Drejtësisë së Branderburgut të Gjermanisë.



Ky takim është realizuar në mbështetje të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme e reformës për arsimim ligjor”

Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi për mënyrën e funksionimit të Akademisë së

Drejtësisë së Bradenburgut si dhe diskutimi i sfidave të përbashkëta rreth trajnimit gjyqësor

Gjatë këtij takimi është prezantuar puna e Akademisë së Drejtësisë së Bradenburgut, mënyra e funksionimit, veçanërisht programet trajnuese të cilat i ofron për përfituesit e saj.

Nga Akademia e Drejtësisë është përcjell me interes prezantimi i Drejtorit të Akademisë së Drejtësisë së Bradenburgut me qëllim që të përfitohet më shumë rreth kurrikulave dhe programeve trajnuese.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin Drejtori i Akademisë, Koordinatori i Programit dhe Udhëheqësit e Programeve.



## Punëtorja për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2018

Më 03-04 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të GIZ-it, ka realizuar “Punëtorinë për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2018”.

Qëllimi i punëtorisë ishte hartimi i Programit Trajnues për vitin 2018, për gjyqtarë dhe prokurorë duke u bazuar në rezultatet nga zhvillimi i mekanizmave për vlerësimin e nevojave trajnuese.



Në punëtori janë përzgjedhur temat që do të jenë pjesë e Programit Trajnues për vitin 2018 si dhe është hartuar draft Programi Trajnues.

Gjatë punëtorisë trajnuesit fillimisht kanë analizuar propozimet e dala nga zhvillimi i mekanizmave për vlerësimin e nevojave trajnuese. Më tej, bazuar në kërkesën e

Akademisë së Drejtësisë rreth strukturës së përgjithshme që duhet të përmbajë Programi Trajnues janë përcaktuar temat me prioritet që duhet të trajtohen gjatë vitit 2018.

Programi Trajnues 2018 do të jetë program një vjeçar dhe përmban tema të karakterit profesional ligjor dhe atij ndërdisiplinor.

Programi reflekton nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe kërkesat e dala nga politikat dhe strategjitë e vendit për gjyqësorin. Në programin janë përfshirë edhe temat e propozuara nga partnerët e Akademisë.

Bazuar në strukturën e përcaktuar për Programin Trajnues 2018, është hartuar koncepti i secilit trajnim duke u mbështetur në sfidat dhe problemet e shfaqura në praktikën gjyqësore në vend.

Koncepti i secilës temë përfshinë qëllimin, ku bëhet përshkrimi i temës, evidentohen dilemat dhe përshkruhet qasja në adresimin e këtyre dilemave gjatë trajnimit. Po ashtu koncepti përmban edhe përmbajtjen, metodologjinë trajnuese, përfituesit e trajnimit si dhe kohëzgjatjen e trajnimit.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin trajnues të Akademisë së Drejtësisë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve.





## Vizitë në institucionet shtetërore dhe ato të drejtësisë të Republikës së Kroacisë

Prej datës 08-09 nëntor 2017, me mbështetjen e UNHCR-së dhe CRPK-së, është realizuar vizita studimore për marrje përvojash në Akademinë Gjyqësore të Kroacisë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme - Sektori për punët administrative dhe inspektuese në tematikën e „Njohjes së thelluar me procedurën e lejimit të mbrojtjes ndërkombëtare (lëmia e azilit) - legjislacionit si dhe praktikës gjyqësore dhe vendimmarrjes në gjykatat e Republikës së Kroacisë”.



Fillimisht është vizituar Ministria e Punëve të Brendshme e Kroacisë – Shërbimi për të huaj dhe azili, ku zyrtarët znj. Anita Mandic, udhëheqëse e Shërbimit për të huaj dhe azil dhe

znj. Sandrina Srsan, udhëheqëse e procedurës për të huaj dhe azil, nga ky institucion kanë ofruar një paraqitje mbi legjislacionin në fuqi të Republikës së Kroacisë dhe implementimin e direktivave të BE-së me të cilat rregullohen çështjet e zhvillimit të procedurës së mbrojtjes ndërkombëtare dhe asaj të përkohshme në Republikën e Kroacisë.

Po ashtu ato janë përgjigjur në çdo pyetje dhe interesim të zyrtarëve kosovar në problematikat e azilit. Pjesëmarrësit kanë vizituar dhe janë njohur më për së afërmi me strukturën dhe funksionet e Qendrës për Pranim të Refugjatëve. Në këtë institucion janë njoftuar me kushtet, procedurat dhe ndërveprimin e institucioneve shtetërore që merren me lëminë e mbrojtjes së refugjatëve.

Pjesë e vizitës ishte edhe takimi në Akademinë e Drejtësisë, ku delegacioni nga Kosova është pritur nga znj. Andrea Pasavec Franiç, Drejtoreshë e Akademisë së Drejtësisë dhe znj. Nella Popoviç, udhëheqëse e Sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar.





Në këtë institucion janë njohur me mënyrën e punës së Akademisë Gjyqësore të Kroacisë, funksionet dhe strukturën e saj. Veçmas zyrtaret kroate kanë dhënë shpjegime mbi programin trajnues që zhvillon kjo Akademi në tematikën e azilit dhe mbrojtjes ndërkombëtare në Republikën e Kroacisë.

Me ftesë të drejtoreshës së Akademisë Gjyqësore të Kroacisë pjesëmarrësit patën rastin të marrin pjesë edhe në tryezën e rumbullakët me temë: “Republika e Kroacisë – 20 vite pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut“, organizuar nga Akademia Gjyqësore dhe Zyra e Përfaqësuesit të Republikës së Kroacisë pranë GJEDNJ, ku patën rastin të njihen hollësisht me të arriturat, pengesat dhe sfidat e Republikës së Kroacisë në zbatimin e Konventës Evropiane për

Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), standardeve dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ në Strasburg.

Pjesëmarrës në këtë vizitë nga Republika e Kosovës kanë qenë: z. Hasan Shala, kryetar i Gjykatës së Apelit, z. Ragip Namani, gjyqtar i Gjykatës së Apeli, znj. Afërdita Bytyçi, kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë, z. Besim Morina, Koordinator i Programit në Akademinë e Drejtësisë, z. Hajriz Hoti, gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, z. Islam Sllamniku, trajnues i përhershëm në Akademi, znj. Melihate Rama, Udhëheqëse e Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm në Akademi, z. Bujar Prebreza zyrtar i Zyrës së UNHCR-së, dhe z. Shadan Horosani, zyrtar i CRPK-së.

## Trajnimi fillestar i bazuar në lëndë – Elaborimi i Doracakut për trajnim të bazuar në lëndë

Më 16 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit – Mbështetje e Mëtejme e Reformës për Arsimim Ligjor, ka realizuar punëtorinë e tretë me radhë “Trajnimi fillestar i bazuar në lëndë - Elaborimin e doracakut për trajnimi të bazuar në lëndë”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte zhvillimi i strukturës së doracakut dhe prezantimi i kapitujve të draftuar, por i përqendruar në lëmin e procedurës civile.

Në këtë punëtori ekspertët kanë bashkëbiseduar rreth strukturës e cila do të ndiqet në hartimin e këtij doracaku. Ata u pajtuan që doracaku të përbëhet nga dy pjesë: pjesa hyrëse, modeli didaktik (të dhëna për trajnuesin) dhe rastin praktik të shkurtuar dhe të përshtatur, ndërsa pjesa e dytë përmban pjesë të përzgjedhur të lëndës së caktuar si: padinë, pyetjet, përgjigjet dhe mjete të cilat do të përdoren nga trajnuesi.

Bazuar në strukturën e përcaktuar ekspertët kanë shkëmbyer mendime dhe përvoja rreth qasjes së trajnimit të bazuar në raste, sa është problematike përzgjedhja e lëndës, shkurtimi i saj për tu prezantuar tek pjesëmarrësit, gjetja e pyetjeve të rëndësishme dhe didaktike.

Po ashtu është diskutuar edhe për përparësitë e mësimin të bazuar në lëndë, ku përfituesit do të kenë mundësi të aplikojnë mjete analitike, artikulojnë problemet, reflektojnë mbi përvojat e tyre relevante dhe të nxjerrin konkluzione që mund të lidhen me detyrat dhe problemet e ardhshme profesionale. Gjithashtu u potencua se kjo formë e të mësuarit zhvillon aftësinë analitike, bashkëpunuese dhe komunikuese.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin trajnues të Akademisë së Drejtësisë nga radhët e gjyqtarëve nga lëmia civile, ekspertë të tjera të angazhuar nga Projekti i Binjakëzimit, dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë.



## Avancimi i metodologjisë së trajnimit

Më 17-18 nëntor 2017, Akademia e Drejtësisë, me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje e Mëtejme e Reformës për Arsimim Ligjor”, ka realizuar trajnimin për trajnues me temë “Avancimi i metodologjisë së trajnimit”.

Trajnimi kishte për qëllim që të kontribuoj në avancimin e mëtejme të metodologjisë së trajnimit që aplikohet në Akademinë e Drejtësisë, me fokus në trajnimet që realizohen në Programin e Trajnimit Fillestar.

Në kuadër të trajnimit u shtjelluan metodat bashkëkohore të trajnimit, përparësitë dhe kufizimet, efikasiteti dhe efektet e secilës prej tyre, si dhe format/mënyrat adekuate të

aplikimit të tyre gjatë realizimit të trajnimit.

Trajnimi kryesisht u fokusua në elaborimin e metodës së trajnimit të bazuar në raste, ku u paraqitën hapat e nevojshëm për përgatitjen e planit dhe mbajtjen e trajnimit. Në këtë kuadër, pjesëmarrësit të ndarë të grupe, me asistencën e ekspertëve të angazhuar për realizim të këtij trajnimi, përgatitën dhe prezantuan idetë e tyre për aplikimin e metodës së trajnimit të bazuar në raste.

Përfitues të trajnimit ishin trajnuesit e Akademisë së Drejtësisë, të angazhuar në realizimin e programit të trajnimit, fusha penale, për gjyqtarët e sapoemëruar.



**<https://ad.rks-gov.net>**

**Adresa “Lagjja e Spitalit”  
Rr. Muharrem Fejza p.n  
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660  
Fax: + 381 38 512 095  
E-mail: [infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)**